MBLEDHJE TË KORRESPODENTËVE TË GAZETËS "PENZIONER PLUS" DHE GAZETËS "KOHA"

LIDHJA ËSHTË KRENARE NDAJ KORRESPODENTËVE TË SAJ PËR SHKAK TË MUNDIT DHE PËRKUSHTIMIT TË TYRE

Më 10.09.2020 u mbajt mbledhja me korrespodentët e "Penzioner plus", gazetës "KOHA" dhe ueb faqes së LSHPM, në të cilën morën pjesë një numër i madh i korrespodentëve, bazuar në të gjitha rekomandimet për mbrojtjen e shëndetit të pranishmëve. Në mbledhjen morri pjesë kryetarja e LSHPM dhe kryetari i Këshillit botues të gazetës Stanka Trajkova.

Të pranishmit e para i përshëndeti dhe iu drejtua kryetarja e Lidhjes dhe Këshillit botues të gazetës, Stanka Trajkova, e cila në mënyrë sublime dhe koncize fliste për rëndësinë e informimit të pensionistëve dhe mes të gjithash tha:

- Të nderuar korrespodentë

Siç është e ditur Informimi në LSHPM ka vend dhe rëndësi të veçantë dhe zhvillim të vet në kuadër të Lidhjes. Informimi ka vend të rëndësishëm në Statutin dhe në LSHPM dhe me dispozitën e nenit 36 është vërtetuar që për informim të anëtarëve dhe opinionit më të gjerë shfrytëzohet shtypi, radio, televizioni, ueb-faqja dhe gazeta e LSHPM "Penzioner plus". LSHPM si organizatë qytetare është e njohur për botimin e gazetës "Penzioner plus" e cila ka të bëjë me shfrytëzuesit e tanishëm dhe të ardhshëm të pensionit në vendin tonë dhe jashtë vendit. Në këtë rast, do ti shfrytëzoj mendimet e personave kompetent për zhvillim të informimit dhe do të them që informacioni rrjedh nga fjali latine "Informatio" që do të thotë një nocion, një përfaqësim, një njohuri, nocion me kuptime të ndryshme varësisht nga konteksti, por sipas rregullit është ngushtë i lidhur me konceptet siç janë: njohuri, udhëzim, përfaqësim dhe stimul mendor. Më tej, njohësit e kuptimit të informacionit thonë që nën termin informacion nënkuptojmë njohuritë që ndryshojnë njohuritë e marrësit gjegjësisht njohuritë që japin kuptim të ri të ndryshme nga ajo e mëparshme. Gjithashtu, një rrethanë e rëndësishme që informacioni është burim i arritjes së njohurive për dukuritë, lëndët dhe ngjarjet në një periudhë dhe kohë të caktuar.

Jo shumë moti në "Penzoner plus" kemi pasur rastin të lexojmë aksentë dhe shfaqje të shkurtë të Informacionit për klubet dhe degët nëpër Shoqatat e pensionistëve. Në atë Informacion kishim tekste dhe numra, gjendje, pasqyra dhe të tjera. Në këtë Informacion u mor vesh si punojnë klubet, sa klube ka çdo shoqatë, çka ndodh në to dhe normalisht që ky informacion, i cili mund të realizohet edhe nga korrespodent, mund të shërben për sjellje të ndonjë vendimi konkret ose ndërmarrje të ndonjë aktiviteti. Shkruani për kartelën sociale, punon vullnetare, përfshirjen dhe për gjithçka që ju rrethon, ndërsa është në interes të pensionistëve.

Te nderuar korrespodentë

Ju jeni bartësit tonë të të dhënave, fakteve, nocioneve dhe njohurisë, të cilët në lloj të tekstesve i shkruani, ndërsa pastaj publikohen në gazetën "Penzioner plus", me tekst, tabela, numra dhe fotografi.

Vazhdoni të na prezantoni sa më shumë informacione, ta doni punën e juaj. Ashtu të gjithë së bashku do ti ndryshojmë gjërat në drejtim më të mirë, në interes për të gjithë ne dhe të pensionistëve të ardhshëm. Të mundohemi që gazeta "Penzioner plus", faqja për pensionistët në "KOHA" dhe ueb faqja jonë të kenë histori më të shpejtë dialekti ndaj më të mirës, të jenë më të pasura me më shumë përmbajtje, ndërsa ueb faqja jonë më e vizituar.

Pastaj përfaqësim kishte edhe redaktoja kryesore dhe përgjegjëse Andonova e cila tha:

- Të nderuar të pranishëm, gëzohem që krahas së gjithave arritëm ta mbajmë këtë mbledhje, që të mund të flasim dhe të merremi vesh sepse ju jeni ata që e shpërndajnë të vërtetën për Lidhjen e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë dhe për shoqatat prej të cilave vini dhe për të cilat shkruani. Këso lloj rrjeti të korrespodentëve nuk kanë media më të mëdha të shkruara dhe elektronike. Gazeta jonë "Penzioner plus" mbijetoi për shkakun tuaj. Në të është ndërtuar mund i madh, mund i juaj, por edhe i shumë korrespodentëve të tjerë të cilët kanë marrë pjesë në të në vitet e fundit. Mes jush ka gazetarë, shkrimtarë, poetë të vërtetuar, por edhe amatorë.

Ju jeni korrespodentë dhe gazetarë, sot kur është shumë vështirë që të jesh. Për shkak të mungesës së rregullativës dhe mbikëqyrjes së Internetit, sot shpërndahen lajme dhe informacione të rrejshme, si dhe gjuha e urrejtjes. Dita ditës, lajmet e rrejshme, dezinformatat dhe spekulimet, shpifjet, diskriminimi dhe fyerjet gjithnjë e më shumë bëhen përditshmëria jonë. Në atë kontest gjithnjë e më shumë thyen standardet për sjellje dhe punë profesionale të gazetarëve dhe mediave. Edhe për LSHPM kishte shfaqje të shpërndarjes të lajmeve të rrejshme me gjuhë të urrejtjes, por me informim objektiv dhe të shpejtë përmes gazetës tonë "Penzioner plus", ueb faqes sonë, si dhe përmes pjesëmarrjes së udhëheqësve tanë në mediat e shkruara dhe elektronike nacionale dhe lokale, ato u demantuan. Edhe pse në ligjet tona ka dispozita për dënim të gjuhës së urrejtjes, rrallë sanksionohet. Megjithatë mirë është që ka paralajmërime për marrje të iniciativës për zbatim koordinativ me fenomenin e lajmeve të rrejshme. Por, të kaloj te gazeta jonë "Penzioner plus". Gazeta rregullisht del në ngjyra në 16 faqe, një prej të cilave është në gjuhën shqipe dhe e rregullon dhe e përkthen me sukses Baki Bakiu. Gazeta del në 6 000 kopje. Prej informacioneve të cilat vijnë është i kërkuar dhe i lexuar, por kuptohet që gjithmonë mund të jetë më mirë edhe ndaj saj duhet jemi të orientuar të gjithë. Shkronjat janë më të mëdha se më herët, fotografitë gjithashtu duhet të jenë më të mëdha. Në të janë të vendosura shkrime të ndryshme, gjegjësisht shkrime të cilat i dërgoni ju, por edhe shkrime me të cilat merrni informacione për punën e Lidhjes. Në çdo rast, të gjithë së bashku mundohemi që informimi të jetë i dyanshëm.

Një pjesë e teksteve të vendosura në "Penzioner plus" një herë në muaj publikohet në një faqe të gazetës "KOHA" në gjuhën shqipe dhe bashkëpunimi është në nivelin e dëshiruar.

Sa për ueb faqen tonë, sipas analizave të mija të shkarkuara nga Interneti, faqja është e vizituar nga shumë vizitorë nga më shumë shtete prej të gjitha kontinenteve. E vizitojnë të rinj dhe të moshuar, edhe në projekte hulumtuese për bashkëjetesën e njerëzve të gjeneratës së tretë. Në faqen tonë 36 shoqata kanë nënfaqe të tyre, do të ishte mirë të gjithë ta kenë.

Në fund një falënderim i madh për mundin dhe përkushtimin tuaj në këtë profesion.

Lidhja mund të jetë krenare ndaj të gjithë juve!

Të pranishmëve iu shpërndanë Rekomandime dhe këshilla për shkrimin e teksteve.

KSA 90

Tradita vazhdon

Edhe këtë vit do të mbahen shfaqjet rajonale të 18-ta të këngës, muzikës dhe lojërave

Më 09.09.2020, Këshilli ekzekutiv i LSHPM mbajti mbledhje me qëllim që të përcaktohen nikoqirët e ri të shfaqjeve rajonale të këngës, muzikës dhe lojërave në vend të atyre nikoqirëve të cilët vendosën që shoqatat e tyre të mos jenë më nikoqir për shkak të pandemisë me Covid 19.

Në mbledhjen ishin "prezentë" të gjithë anëtarët. Vendimi u soll unanimisht.

Shfaqjet rajonale të këngës, muzikës dhe lojërave do të mbahen edhe atë më:

22 shtator 2020 - nikoqir SHP Lozovë

23 shtator 2020 - nikoqir SHP Veles

24 shtator 2020 - nikoqir SHP Makedonska Kamenica

25 shtator 2020 - nikoqir SHP Demir Hisar

29 shtator 2020 - nikoqir SHP Saraj

30 shtator 2020 - nikoqir SHP Karposh

1 tetor 2020 - nikoqir SHP Çair

Në shfaqjet do të marrin pjesë pensionistët prej 39 prej 53 shoqatave, që tregon që 74% shoqata do ta vazhdojnë traditën e mbajtjes së shfaqjeve rajonale të këngës, muzikës dhe lojërave edhe këtë vit, kuptohet sipas rekomandimeve që u parashtruan.

Në mbledhjen u vendos që të gjitha shoqatat nikoqire të shfaqjeve rajonale të 18-ta të këngës, muzikës dhe lojërave do të marrin nga 40 000 denarë mbështetje financiare nga LSHPM, si organizator të shfaqjeve rajonale të këngës, muzikës dhe lojërave.

Menka Temelkovska